



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca / Office of the
Chief State Prosecutor

Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave / Kancelarija za Zastupanje i Pomoć Žrtvama /
Victims Advocacy and Assistance Office

A nr.521/2024

Datë: 04.11.2024

Prishtinë

Në bazë të nenit 20 par.1 nënpar.1.13 të Ligjit NR. 08/L-167 UD Kryeprokurori i Shtetit
nxjerr këtë,

UDHËZIM

MBI PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT TË ZYRËS PËR MBROJTJE DHE NDIHMË VIKTIMAVE

KREU I TË DREJTAT E VIKTIMËS

Historiku

Të drejtat e viktimës janë të drejta të njeriut që duhet të mbrohen nga shteti. Në vitin 1985, OKB e ka miratuar Deklaratën e parimeve themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe abuzimit të pushtetit, e cila i paraqet praktikat më të mira ndërkombëtare për trajtimin e viktimave të krimit. Bashkësia ndërkombëtare ka pranuar që viktimat e krimit gëzojnë të drejtën për trajtim të duhur dhe qasje në mekanizmat e drejtësisë, dhe njeh obligimin e kryerësit për kompensim të drejtë të viktimave të tij/saj.

Kosova i ka krijuar mekanizmat për të siguruar që mbrojtja e të drejtave të njeriut, përkatësisht e të drejtave të viktimave dhe do t'i plotësojë këto obligime. Divizioni për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave është themeluar në vitin 2002 brenda Departamentit të Drejtësisë, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/1.

Pas themelimit të Ministrisë së Drejtësisë, kjo njësi ka vazhduar të funksionojë brenda Departamentit për Qasje në Drejtësi. Shërbimi i Mbrojtësve të viktimave fillimisht u

përqendrua në viktimat e trafikimit në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2001/4 dhe në viktimat e dhunës në familje në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2003/12 më pas u zotua për mbrojtje aktive të viktimave të dhunës në familje dhe abuzimit seksual. Sipas rregulloreve të UNMIK-ut, mandati i mbrojtësve të viktimave ishte që viktimave t'u ofrojnë udhëzime, këshilla dhe mbështetje në sistemin e drejtësisë, t'i shoqërojnë ato në gjykatë, gjatë transportimit, në strehimore, qendra shëndetësore dhe shërbime tjera sociale. Mbrojtësit e viktimave kishin vepruar në 14 zyra rajonale në tërë Kosovën.

Gjatë vitit 2011, Ministria e Drejtësisë e kishte transferuar Divizionin për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave në zyrën e Kryeprokurorit të shtetit. Në këtë cilësi të re, roli i mbrojtësve të viktimave është zgjeruar për të qenë në pajtim me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës i cili kishte hyrë në fuqi në janar të vitit 2013, më pas edhe Kodit Procedurës Penale të Kosovës të vitit 2022, Ligjit të ri të Dhunës në Familje, Dhunës në Bazë Gjinore dhe Dhunës ndj Grave nr. 08/L-185 dhe Ligjit për Prokurorin e Shtetit nr. 08/L-167. Roli dhe përgjegjësisitë e Mbrojtësit të Viktimave është avancuar duke ia shtuar përgjegjësi dhe obligime në mbrojtjen dhe përfaqësimin e viktimave në sistemin e drejtësisë. Dokumentet e renditura më poshtë shërbejnë si bazë ligjore për të drejtat e viktimës brenda Republikës së Kosovës.

Pika 1 -Parime të përgjithshme

- I. ZMNV sigurohet që viktimat të trajtohen me respekt, ndjeshmëri në mënyrën profesionale dhe jo-diskriminuese gjatë të gjitha fazave procedurale si në prokurori dhe në gjykatë.
- II. Të gjitha viktimat e krimit kanë të drejtë në mbrojtjen e të drejtave të tyre.
- III. ZMNV ofron shërbime profesionale për të gjitha viktimat e krimit që kërkojnë një gjë të tillë.
- IV. Në pajtim me Rregulloren nr.02/2024 për mandatin, strukturën, funksionimin dhe organizimin e Zyrës për mbrojtje dhe ndihmë viktimave, ZMNV trajton me prioritet ofrimin e mbështetjes dhe përfaqësimin në prokurori dhe gjykata të viktimave të dhunës në familje, trafikimit me qenie njerëzore, veprat penale kundër integritetit seksual, abuzime dhe keqtrajtime të fëmijëve.
- V. ZMNV siguron në ruajtjen e plotë të privatësisë dhe konfidencialitetit të të dhënave të ndjeshme të viktimave të krimit.

Pika 2 - Të drejtat bazike të viktimave

- I. Të drejtat e viktimave të krimit janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në Kodin e Procedurës Penale dhe si të tilla zbatohen dhe respektohen edhe nga ZMNV. Të drejtat e tilla janë në pajtim të plotë me Direktivën e BE-së nr.2012/29 për caktimin e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimeve.

- II. Viktimat e krimit duhet të trajtohen me respekt, dinjitet dhe pa diskriminim në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

Pika 3 - Legjislacioni tjetër vendor që rregullon të drejtat e viktimave

- I. Kushtetuta e Republikës së Kosovës- Kapitulli II të drejtat dhe liritë themelore.
- II. Korniza e përgjithshme ligjore:
- a. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës;
 - b. Kodi i Drejtësisë për të mitur;
 - c. Ligji për procedurën kontestimore;
 - d. Ligji për Kompensimin e viktimave të krimit;
 - e. Ligji mbi familjen;
 - f. Ligji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;
 - g. Ligji për barazi gjinore;
 - h. Ligji për ndihmë juridike falas;
 - i. Ligji për shërbime sociale dhe familjare;
- III. Korniza ligjore për mbrojtjen nga dhuna në familje, dhunës në bazë gjinore dhe dhunës ndaj grave:
- a. Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje, dhunës në bazë gjinore dhe dhunën ndaj grave;
 - b. Strategjia kombëtare kundër dhunës në familje;
 - c. Procedurat standarde për mbrojtjen nga dhuna në familje;
 - d. Protokolli shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale;
- IV. Korniza ligjore për mbrojtjen e viktimave të trafikimit me njerëz:
- a. Ligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit;
 - b. Strategjia kombëtare kundër trafikimit me njerëz;
 - c. Procedurat standarde të veprimit për personat e trafikuar në Kosovë dhe
 - d. Standardet minimale të kujdesit për viktimat e trafikimit.
- V. Të gjitha aktet tjera nënligjore që derivojnë nga legjislacioni në fuqi në këtë fushëveprimtari.

Pika 4 -Instrumentet tjera ndërkombëtare relevante

- I. Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës jep një listë të gjerë të dokumenteve që kanë zbatueshmëri të drejtpërdrejtë dhe që në rast konflikti me dispozitat ligjore kanë prioritet. Kjo listë përfshin:
 - a. Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut;
 - b. Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
 - c. Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
 - d. Konventën Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
 - e. Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
 - f. Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
 - g. Konventën për të Drejtat e Fëmijës;
 - h. Konventën kundër Torturës dhe rajtimeve e Ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese;
 - i. Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje- Konventa e Stambollit.
- II. Kushtetuta e Republikës së Kosovës gjithashtu në Nenin 53 të saj në mënyrë decitive thekson se të drejtat e njeriut duhet të interpretohen në harmoni me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- III. Duke pasur parasysh aspiratat e Republikës së Kosovës për të qenë pjesë e Këshillit të Evropës është me rëndësi që praktikat sidomos në fushën e ofrimit të mbrojtjes për viktimat e krimit të jenë në linjë edhe me dokumente tjera relevante që rregullojnë këtë fushë e që përfshijnë por nuk kufizohen në:
 - a. Deklarata e Asamblesë së Përgjithshme të OKB mbi parimet bazë të drejtësisë për viktimat e krimit dhe abuzimit të pushtetit.
 - b. Direktiva e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian për krijimin e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit.
 - c. Direktiva e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të saj.
 - d. Direktiva Evropiane për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme.

KREU II

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME PROCEDURALE

Pika 5- Përfaqësimi i viktimës

- I. Mbrojtësi i viktimave është i autorizuar të përfaqësojë viktimën në procedurën penale dhe në procedurën civile për kërkesën për urdhër mbrojtje. Mbrojtësi i viktimave nuk do të përfaqësojë viktimat të cilat njëkohësisht kanë zgjedhur të përfaqësohen nga avokat të licencuar nga Oda e Avokatëve. Krahas njoftimit të viktimës për të drejtat e tyre, e njofton viktimën qysh në kontaktin e parë që në rast të angazhimit të avokatit, sipas ligjit përfundohen shërbimet e mbrojtësit të viktimave për përfaqësim në procedurën penale dhe civile.
- II. Viktimat ruajnë të drejtën që gjatë fazave të procedurës të kërkojë përsëri ndihmën e mbrojtësit të viktimave në rast se nuk përfaqësohet më tutje nga avokati mbrojtës.
- III. Mbrojtësi i viktimave nuk merr pjesë në përfaqësim të palës e cila njëkohësisht ka cilësinë edhe të pandehurit edhe të viktimës apo në rastin kur të dyja palët cilësohen si të pandehur. Nëse Mbrojtësi i viktimave ftohet nga prokurori apo gjykata për përfaqësim të tillë, Mbrojtësi i viktimave duhet siguruar të njoftojë prokurorin, respektivisht gjykatën se shërbimet e ZMNv ofrohen vetëm në rastet kur pala është kualifikuar si viktimë. Në të njëjtin njoftim, Mbrojtësi i viktimave i bën të ditur prokurorit, respektivisht gjykatës se nëse në fazat e mëvonshme të procedurës ndonjëra nga palët merr cilësinë e viktimës, atëherë mund të ofrohen shërbimet e Mbrojtësi i viktimave nëse kërkohet një gjë e tillë.

Pika 6

Kontakti i parë

- I. Koha dhe vendi i kontaktit të parë ndërmjet viktimës dhe mbrojtësit të viktimave do të përcaktohen në bazë të një sërë faktorësh të përmendur më poshtë.
- II. *Kontakti gjatë orarit të punës:* Kontakti i parë bëhet gjatë orarit të punës përveç nëse nuk ekziston ndonjë përjashtim nga ato të paraqitura në paragrafin (3) të kësaj pike.
- III. *Koha e reagimit në rast:*
 - a. Kontakti i parë bëhet në ditën tjetër të punës pas identifikimit të viktimës apo sa më parë gjatë orarit të punës në kohën më të volitshme për viktimën.
 - b. Për veprat penale që përfshijnë numër të madh të viktimave, kontakti i parë konsiderohet edhe njoftimi që i dërgohen të gjitha viktimave për t'i informuar ato rreth të drejtave të tyre dhe ndihmën që është në dispozicion.
- IV. Reagimi i menjëhershëm jashtë orarit të rregullt të punës:

- a. Përjashtimisht, kontakti i parë ndërmjet viktimës dhe mbrojtësit të viktimave mund të bëhet edhe jashtë orarit të rregullt të punës në këto rrethana:
 - i. Kur pala e dëmtuar e ka kërkuar njoftimin dhe komunikimin me mbrojtësit të viktimave në një rast me prioritet, sipas rregullores së ZMNV.
 - ii. Kur për shkak të rrethanave të kryerjes së veprës penale vlerësohet se kontakti i menjëhershëm i mbrojtësit të viktimave me viktimën është i domsdoshëm.

V. *Vendi dhe mënyra e komunikimit me viktimën:*

- a. Komunikimi fillestar i mbrojtësit të viktimave me viktimën mund të bëhet përmes telefonit.
- b. Kontakti i parë me viktimën mund të bëhet në disa lokacione:
 - Në zyrën e mbrojtësve të viktimave.
 - Në dhomat e intervistimit të viktimave në prokurori. Përdorimi i këtyre dhomave për viktimat inkurajohet sidomos në rastet kur viktimat shoqërohet nga fëmijët e saj/tij.
 - Në një vend që është i përshtatshëm për viktimën sikurse në strehimore, qendër për punë sociale, gjykatë apo ndonjë insitucion tjetër zyrtar nëse mbrojtësi i viktimave konstaton që një gjë e tillë është në interesin më të mirë të viktimës.
 - Në stacionin policor nëse ai kontakt përkon me rastet sipas paragrafit III të kësaj pike.

Pika 7 - Procedura e kontaktit me viktimën

- I. Mbrojtësi i viktimave i merr informatat dhe shkresat e lëndës nga hetuesi policor, prokurori apo edhe gjykata. Varësisht nga rasti dhe vlerësimit të mbrojtësit të viktimave, i njëjti mund të takohet me viktimën pa praninë e akterëve tjerë.
- II. Mbrojtësi i viktimave në të gjitha kontaktet me viktimën dhe akterët tjerë duhet ta mbajë kartelën e identifikimit. Mbrojtësi i viktimave e prezanton vetën dhe e këshillon dhe informon viktimën lidhur me rolin e mbrojtësit të viktimave. Më pas mbrojtësi i viktimave ia sqaron viktimës të drejtat që ai/ajo i ka si viktimë, procedurat gjyqësore si dhe shërbimet tjera në dispozicion.
- III. Mbrojtësi i viktimave e dokumenton cdo kontakt dhe komunikim me viktimën në dosjen e rastit. Kontakti me viktimën dokumentohet edhe në raportet javore të punës.
- IV. Nëse viktimë është fëmijë apo i/e mitur, mbrojtësi i viktimave sigurohet që zyrtarët policor e kanë kontaktuar Qendrën për Punë Sociale dhe akterët tjerë të cilët kanë përgjegjësi dhe mandat të ofrojnë mbrojtje viktimave fëmijë.
- V. Kur viktimë është fëmijë apo i/e mitur, mbrojtësi i viktimave sigurohet që gjatë marrjes së deklaratës së fëmijës nga ana e akterëve tjerë përgjegjës të bëhet saktësisht përshkrimi i dhënë nga fëmiju pa përfshirë gjuhë të përgjithësuar.
- VI. Gjërat që duhen shmangur gjatë kontaktit me viktimën:

- a. Shmangia e pyetjeve jorelevante me rastin, përfshirë edhe pyetjet intime, të kaluarën seksuale të viktimës apo jetën intime aktuale.
- b. Shmangia e shprehjeve dhe zhargoneve seksiste dhe diskriminuese, paragjykimet të viktimës dhe fajësimit për veprimet apo mosveprimet e saj/tij.

Pika 8 - Identifikimi i viktimës

- I. Viktimat e krimit do të identifikohen nga ZMNV-ja në pajtim me procedurat në vijim:
 - a. Pas identifikimit nga policia kur kërkohet reagim i menjëhershëm nga mbrojtësi i viktimave
 - b. Pas shqyrtimit të Raportit Ditor të Incidentit (RDI) nga mbrojtësi i viktimave. Udhëheqësi i zyrës regjionale ose mbrojtësi i viktimave do ta shqyrtojë RDI-në për çdo ditë të punës për ta vlerësuar nevojën për kontaktimin e viktimave individuale të krimit. RDI-të e vikendeve apo ditëve të festës do të shqyrtohen ditën vijuese të punës.
 - c. Pas identifikimit të viktimës nga RDI, ZMNV e kontakton viktimën dhe e njofton atë për të drejtat e tij/saj për shërbimet e ZMNV-së.
 - 1.1 Me kërkesë të viktimës.
 - 1.2 Me ftesë të prokurorisë.
 - 1.3 Me ftesë të gjykatës.
 - 1.4 Për referimet nga prokuroria, ZMNV-ja e konfirmon që viktimat e referuar i plotëson standardet e parapara në Pjesën IV, pikën 23. Pas konfirmimit të kriterëve, ZMNV-ja e kontakton viktimën për ta njoftuar atë për të drejtën e tij/saj për shërbime të ZMNV-së.
- II. Mbrojtësi i viktimave pranon ftësën për paraqitje në prokurori dhe gjykatë në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Pika 9 -Përkrahja shtesë

- I. *Vlerësimi.* Me marrjen e rastit, mbrojtësi i viktimave i vlerëson nevojat e viktimës për shërbime shtesë nga mbrojtësi i viktimave apo edhe nga ofrues tjerë të shërbimeve dhe ndërmerr veprimet e duhura për plotësimin e atyre nevojave.
- II. *Referimi.* Me kompletimin e vlerësimit, mbrojtësi i viktimave e referon viktimën tek zyra kompetente e mbrojtësve të viktimave apo edhe tek ofruesit e duhur të shërbimeve.
- III. *Bashkërendimi.* Mbrojtësi i viktimave mund t'i bashkërendojë përpjekjet e ofruesve të shërbimeve për t'u siguruar që viktimat e krimit të pranojnë ndihmën dhe shërbimet e duhura.
- IV. *Bartja e rastit në kompetencë në rastet e kërkesave për urdhër Mbrojtje.* Udhëheqësi i zyreve regjionale e bart në kompetencë një rast atëherë kur viktimat e ndërron

vendqëndrimin dhe tutje rasti bartet në zyren regjionale të mbrojtësve të viktimave e cila bie në juriksionin e gjykatës me kompetencën territoriale. Mbrojtësi i viktimave i caktuar në rastin e parë, siguron që zyra regjionale ku është bartur rasti të pajiset me gjithë dokumentacionin dhe shkresat e lëndës, si dhe siguron kontakten e viktimës me zyren regjionale. Kur një rast me kërkesë për udhër mbrojtje bartet nga një zyre regjionale në tjetrin, rasti përkatës regjistrohët në databazën SEZMNV në regjionin ku ka ndodhur rasti.

Pika 10- Pranimi apo refuzimi i shërbimeve nga viktimat

- I. *Njoftimi.* Mbrojtësi i viktimave duhet ta informojë secilën viktimë për të drejtat e tij/saj dhe për shërbimet e mundshme në dispozicion. Mbrojtësit e viktimave duhet ta këshillojnë viktimën për pasojat e mundshme që mund të dalin nga kërkimi apo heqja dorë nga ato të drejta si dhe nga pranimi apo refuzimi i shërbimeve të mundshme.
- II. *Pëlqimi.* Mbrojtësi i viktimave e dokumenton pëlqimin e viktimës për pranimin e shërbimeve dhe kërkimin e të drejtave.
Heqja dorë. Mbrojtësi i viktimave e dokumenton heqjen dorë apo refuzimin e të drejtave dhe shërbimeve nga ana e viktimës. Përmes shënimit zyrtar apo deklaratës së viktimës, mbrojtësi i viktimave e identifikon dhe dokumenton se cilat të drejta apo shërbime janë refuzuar nga viktimat. Nëse viktimat tërheqet gjatë cilësdo fazë të procedurës apo nuk i bashkëngjitet fare ndjekjes penale, mbrojtësi i viktimave nuk mund të vazhdojë të deklarohet në emër të viktimës. Një shembull konkret mund të jenë rastet kur viktimat në fund të shqyrtimit gjyqësor heq dorë nga paraqitja e fjalës përfundimtare. Në këto raste Mbrojtësi i Viktimave deklarohet se bazuar në tërheqjen e viktimës edhe Mbrojtësi i viktimave heq dorë nga paraqitja e fjalës përfundimtare pasi ka pushuar baza e prezantimit në emër të viktimës sipas Nenit 352 të KPPRK, kur viktimat heq dorë nga një gjë e tillë.
MV-ja duhet ta këshillojë viktimën që ai/ajo mund të kërkojë dhe pranojë ndihmë përsëri në të ardhmen.

Pika 11- Ofrimi i ndihmës gjatë procedurës penale

- I. Gjatë intervistimit ose marrjes së deklaratës së viktimës në procedurën paraprake, mbrojtësi i viktimave sipas nevojës dhe vlerësimit të nevojave emergjente të viktimës mund t'i propozojë policisë apo prokurorit vazhdimin, ndërprerjen apo shtyerjen e intervistimit të viktimës. Mbrojtësi i viktimave e pranon një kopje të deklaratës së viktimës nëse viktimat ka dhënë deklaratë.
- II. Mbrojtësi sigurohet që viktimat të jetë informuar për të drejtat e tij/saj, për emrin dhe informatat kontaktuese të hetuesit të cilit iu është caktuar rasti, numrin e mbrojtësit të viktimave dhe numrin e linjës ndihmëse.

- III. Mbrojtësi i viktimave e monitoron respektimin e të drejtave të viktimës gjatë gjithë procedurës penale. Në rast të shkeljes së të drejtave të viktimës, mbrojtësi i viktimës intervenon në emër të viktimës për të parandaluar shkeljen apo vazhdimin e shkeljes.
- IV. Mbrojtësi i viktimave siguron mbrojtjen e të drejtave të viktimës derisa prania e viktimës të mos jetë më e nevojshme apo derisa viktima të vendos që ta shtyjë apo ndërpres bashkëpunimin.

Pika 12 - Ofrimi i ndihmës gjatë procedurës së kërkesës për urdhër mbrojtje

- I. Mbrojtësi i viktimave është i obliguar të përpilojë dhe paraqes kërkesën për urdhër mbrojtje me pëlqimin e viktimës. Në të gjitha rastet mbrojtësi i viktimave është i obliguar të paraqes kërkesën për urdhër mbrojtje me dhënien e pëlqimit të viktimës me shkrim me prezencën fizike.
- II. Përfshijë, mbrojtësi i viktimave mund të përpilojë kërkesën për urdhër mbrojtje emergjente dhe atë të rregullt në emër të viktimës pa prezencën e saj/tij fizike në rastet kur:
 - a. Viktima e ka të pamundur të jetë prezente për dhënien e pëlqimit me shkrim dhe mbrojtësi i viktimave merr pëlqimin gojarisht nga viktima përmes mjeteve të komunikimit dhe e përpilon kërkesën për urdhër mbrojtje, gjithmonë në mbështetje të provave dhe arsyetimin për kërkesën për shqiptimin e urdhërit mbrojtës.
 - b. Viktima e ka të pamundur të jetë prezente për dhënien e pëlqimit me shkrim mirëpo është deklaruar në polici se kërkon masa mbrojtëse nga kryesi dhe mbrojtësi i viktimave i posedon provat nga policia për të mbështetur kërkesën për urdhër mbrojtje.
 - c. Kur mbrojtësi nuk arrin të kontaktojë viktimën, mirëpo ekziston dyshimi për rrezik të drejtpërdrejt dhe i menjëhershëm për sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e viktimës dhe mbrojtësi i viktimave i posedon provat për mbështetjen e kërkesës për urdhër mbrojtje emergjente.
- III. Mbrojtësit e viktimave duhet të sigurohen që në kërkesën për UM të përfshijë edhe arsyetimin për secilën masë të kërkuar.
- IV. Mbrojtësi i viktimave duhet të specifikojë dhe bashkëngjies provat në dispozicion në mbështetje të kërkesës për Urdhër Mbrojtje.

Pika 13- Vazhdimi i kontaktit

- I. Mbrojtësi i viktimave në vazhdimësi ia siguron viktimës informata të nevojshme në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore. Mbrojtësi i viktimave duhet të informojë viktimën për çdo arrestim të pandehurit, seancë dëgjimore për paraburgim për të pandehurin apo paraqitje në gjykatë për të cilat mbrojtësi ka njohuri.
- II. Mbrojtësi i viktimave ia siguron viktimës informatat për kontaktimin e tij/saj dhe numrin e linjës ndihmëse.

- III. Mbrojtësi i viktimave e përcakton një metodë për vazhdimin e kontaktit me viktimën.
- IV. Mbrojtësi i viktimave udhëzon viktimën për ruajtjen e provave, faturave dhe dokumenteve tjera relevante për çështjet e realizimit të dëmtshpërblimit në procedurën penale apo edhe kompensimit nga shteti.
- V. Mbrojtësi i viktimave e vazhdon kontaktin me viktimën në zyret e mbrojtësve të viktimave, sipas nevojës edhe në strehimore, qendër për sociale, prokurori, gjykatë apo në hapësirat e institucioneve tjera zyrtare.
- VI. Mbrojtësi i viktimave mund ta takojë viktimën edhe në dhomat e intervistimit të viktimave në prokuroritë themelore ku ekzistojnë ato. Përdorimi i këtyre dhomave për viktimat inkurajohet sidomos në rastet kur viktimat shoqërohet nga fëmijët e saj/tij.

Pika 14- Përfundimi i ofrimit të shërbimeve

- I. Shërbimet e ZMNV përfundojnë me:
 - a. heqjen dorë/refuzimin nga viktima;
 - b. shterimin e mjeteve juridike në sistemin e drejtësinë penale;
 - c. shterimin e shërbimeve ligjore që ndërlidhen me urdhrin për mbrojtje;
 - d. përcaktimin e ekzistimit të konfliktit të interesit;
 - e. me angazhimin e avokatit mbrojtës nga viktima;
 - f. rrethana tjera që mund të përbëjnë shkak për përfundim të shërbimeve.
- II. Asgjë në këtë dispozitë nuk e ndalon ZMNV-në që ta këshillojë viktimën nëse mbrojtësi i viktimave e konstaton që mund të ketë rrezik të lartë për viktimën në rastet kur i pandehuri të jetë liruar apo të ketë ikur nga paraburgimi. Në ato rrethana, mbrojtësi i viktimave e këshillon viktimën për shërbimet në dispozicion.
- III. MV-ja e njofton hierarkinë e ZMNV-së për ndërprerjen e rastit.
- IV. Në rast të heqjes dorë nga viktima gjersa rasti është ende në gjykatë, MV-ja i paraqet gjykatës njoftimin gojarisht apo me shkrim për ndërprerje të shërbimeve të ZMNV-së dhe e thekson arsyen e ndërprerjes.

Pika 15- Trajtimi i rasteve me prioritet

- I. Në rastet kur ka kërkesa për ofrimin e mbështetjes dhe ndihmës ndaj viktimave të kategorive tjera të veprave penale, mbrojtësi i viktimave i jep prioritet trajtimit të rasteve të përcaktuara sipas rregullores së ZMNV.
- II. Trajtimi me prioritet nënkupton edhe trajtimin në mënyrë të përshpejtuar në aspektin kohor, duke ofruar shërbime sa më parë që është e mundur për të shmangur vonesat në procedurë.

Pika 16- Shmangia e kontaktit me kryesin

1. Të gjithë zyrtarët e ZMNV-së obligohen t'i shmangen çfarëdolloj të kontaktit me kryesin e veprës.
2. Mbrojtësit e viktimave obligohen të bëjnë përpjekje të shmangët kontakti i viktimës me kryesin. Mbrojtësit e viktimave nuk duhet të lehtësojnë në asnjë rast kontaktin mes viktimës dhe kryesit.

Pika 17 - Aspekte logjistike të ofrimit të shërbimeve

- I. *Databazat*: Mbrojtësi i viktimave i regjistron të gjitha rastet, të dhënat dhe veprimet procedurale në databazën e zyres, respektivisht në SEZMNV, gjatë të njëjtës dite apo më së largu 48 orë nga pranimi i rastit, respektivisht veprimi procedural. Mbrojtësi i viktimave ka për obligim regjistrimin e të dhënave edhe në databazën nacionale të dhunës në familje dhe databazën nacionale për rastet e trafikimit me njerëz sipas afateve të parapara me rregullativën përkatëse.
- II. *Transporti personal*: Ndalohet përdorimi i veturave personale për qëllime zyrtare si për realizimin e kontaktit me viktimën, përfaqësimin në polici, prokurori apo gjykata, apo edhe pjesëmarrje në takime të ndryshme zyrtare.

KREU III LINJA NDIHMËSE

Pika 18 - Pranimi i thirrjeve

- I. Zyrtarët e linjes ndihmëse kanë përgjegjësinë t'i përgjigjen të të gjitha thirrjeve 24 orë 7 ditë në javë. Thirrjet pranohen në telefonin celular poashtu edhe në telefonin fiks të vendosur në zyren regjionale të mbrojtësve të viktimave në Prishtinë.
- II. Zyrtarët e linjes ndihmëse duhet të jenë në gjendje t'i lajmërohen thirrjeve dhe të ofrojnë informata në të gjitha gjuhët zyrtare të vendit. Poashtu zyrtarët duhet të jenë në gjendje të komunikojnë edhe në gjuhën angleze për të ofruar ndihmë viktimave të huaja.
- III. Thirrjet në linjen ndihmëse janë anonime dhe identiteti i viktimës nuk zbulohet përveç në rastet kur:
 - a. viktima e identifikon veten dhe kërkon ndihmën e menjëhershme dhe
 - b. kërkohet pëlqimi i viktimës të zbulojë identitetin në rastet kur zyrtari i linjes vlerëson se ekziston rreziku i drejtëpërdrejt për jetën e viktimës dhe rasti duhet të referohet në polici apo organ tjetër i ndihmës direkte.

Pika 19- Informimi dhe këshillimi

- I. Linja ndihmëse i ofron të gjitha informatat e nevojshme për viktimat që thërrasin për të kërkuar informata, udhëzime, këshillim apo ndihmë.
- II. Zyrtarët e linjes ndihmëse duhet:
 - a. të njohin natyrën e dhunës, të identifikojnë format e ndryshme të dhunës dhe poashu t'i njohin ligjet kryesore për mbrojtjen e viktimave të krimit.
 - b. të ofrojnë udhëzime dhe këshilla ligjore bazike lidhur me të drejtat e viktimave të formave të ndryshme të dhunës përfshirë dhunën në familje, dhunës në bazë gjinore, trafikimit me njerëz, dhunës seksuale dhe abuzimit e keqtrajtimit të fëmijëve.
 - c. të posedojnë dhe të ofrojnë informata të sakta dhe kontakte të institucioneve të ndryshme përgjegjëse që ofrojnë ndihmë direkte dhe shërbime mbështetëse për viktimat përfshirë këtu numrat kontaktues të policisë në krejt vendin, numrat kontaktues të qendrave për punë sociale, numrat kontaktues të mbrojtësve të viktimave, të zjarfikësit, të ambulancës, të qendrave të shëndetit familjar, strehimoreve etj.
 - d. të jenë në gjendje që të ofrojnë informata dhe të udhëzojnë viktimat e huaja edhe për shërbimet tjera ekzistuese për mbështetjen e viktimave në vendet e tyre.
 - e. të udhëzojnë dhe këshillojnë viktimat në përpilimin e planit të sigurisë ashtu që viktima të mund të identifikojë mënyra të ndryshme si të:
 - i. largohet nga shtëpia në rastet e rrezikut për jetë nga kryesi;
 - ii. sigurojë veten në rastet kur kryesi posedon armë;
 - iii. të kujdeset për sigurinë gjatë largimit nga kryesi dhe
 - iv. të kujdeset për sigurinë në rastet kur kryesi nuk jeton me viktimen.

Pika 20- Qasja ndaj viktimave

- I. Zyrtarët e linjes ndihmëse duhet:
 - a. të kenë një qasje pro-viktimë gjatë komunikimit me viktimen e cila përfshinë respektin, mosdiskriminimin, qasjen jo-gjyquese, ruajtjen e konfidencialitetit dhe marrjen e pëlqimit të viktimit para se të ndërmarrin hapat e mëtutjeshme në emër të viktimit.
 - b. të ofrojnë ndihmë duke mos e diskriminuar e paragjykuar moshën, gjininë, orientimin seksual, identitetin gjinor, nacionalitetin, etnicitetin, gjuhën, statusin socio-ekonomik apo edhe mendimet ndryshe të personit që thërret për të kërkuar informacion, udhëzime dhe ndihmë.
 - c. të kenë shkathtësi të zhvilluar të komunikimit përmes telefonit duke ia mundësuar viktimave të shprehin shqetësimet apo nevojat e tyre, të menaxhojnë situata krizash në të cilat mund të gjendet viktima në momentin e thirrjes dhe të jenë në gjendje t'i përgjigjen dhe t'i ofrojnë ndihmën adekuate.

- d. të përdorin një gjuhë të lehtë dhe të thjeshtë gjatë komunikimit me thirrësit/viktimat në telefon duke marrë parasysh që jo të gjithë thirrësit mund të kuptojnë terminologjinë ligjore ose t'i njohin institucionet përgjegjëse dhe shërbimet ekzistuese.
- e. të kenë empati të zhvilluar, të dëgjojnë viktimën dhe të mundohen të kuptojnë shqetësimet e viktimës. Poashtu duhet të njohin shenjat kryesore të traumës të cilat mund të manifestohen edhe gjatë komunikimit përmes telefonit.
- f. të jenë të sigurtë me viktimën për ndihmën që mund të ofrojnë përmes telefonit, të mos japin premtime, të mos e imponojnë gjykimin e tyre tek viktimat, dhe të mos i bëjnë presion viktimës për të raportuar apo referuar rastin më tutje.

Pika 21- Referimi

- I. Zyrtarët e linjes ndihmëse i referojnë viktimat në polici në rastet kur:
 - a. viktimat kërkon ndihmën e zyrtarit të linjes për të kontaktuar policinë sepse ndihet e rrezikuar;
 - b. janë të bindur se viktimat që ka thirrë në linjë është në rrezik të drejtpërdrejt nga kryesi ngase gjatë thirrjes ka indikacione të dhunës si psh dëgjoen bërtima, zhurma, të shtëna armësh, viktimat qan apo dëgjoen bërtima apo të qara të fëmijëve etj;
- II. Zyrtarët e linjes ndihmëse duhet të bashkëpunojnë ngushtë me mbrojtësit e viktimave dhe në të gjitha rastet kur viktimat kërkon ndihmën e mbrojtësit të viktimave e mundësojnë kontaktin e viktimës me mbrojtësin e viktimave në regjionin e caktuar.
- III. Zyrtarët e linjes ndihmëse mund të referojnë rastet edhe në Qendrat për punë sociale, nëse viktimat ka nevojë për shërbime të mëtutjeshme e sidomos në rastet kur viktimat janë fëmijë apo kanë fëmijë.
- IV. Zyrtarët e linjes ndihmëse mund të referojnë apo të thërrasin drejtpërdrejt ndihmën e shpejtë ose zjarrfikësin në rastet kur viktimat kërkon dhe ka nevojë për ndihmë të menjëhershme.
- V. Zyrtarët e linjes ndihmëse dokumentojnë përmes shkresës zyrtare çdo thirrje të pranuar përmes lindjes përfshirë të dhënat e thirrësit, përshkrimi i hollësishëm i rastet dhe shërbimet e ofruara nga linja. Në rastet e referimit të rastit tek institucionet tjera, përgatitet raporti specifik për rastin e referuar.

Pika 21- Vetëdijësimi i publikut

- I. Zyrtarët e linjes ndihmëse duhet të angazhohen në aktivitet të ndryshme për promovimin e linjes ndihmëse dhe informimin dhe vetëdijësimin e publikut për të drejtat e viktimave. Këto aktivitetet mund të përfshijnë:

- a. përgatitjen dhe shpërndarjen e fletushkave/materialeve informative;
 - b. takimet/sesionet informuese me nxënës, studentë, organizata jo-qeveritare dhe grupe tjera interesi;
 - c. promovim i linjes ndihmëse në spote televizive, radio apo mjete tjera të mediave sociale etj.
- II. Zyrtarët e linjes ndihmëse duhet të komunikojnë dhe bashkëpunojnë edhe me institucione tjera përgjegjëse për mbrojtjen e viktimave.

KREU IV

BASHKËRENDIMI ME INSTITUCIONE DHE OPRUES TË SHËRBBIMEVE

Pika 23 -Detyrat e mbrojtësve të viktimave për bashkërendim me policinë

- I. Identifikimi i çdo viktime të krimit fillon me zbatuesit e ligjit. Agjencitë për zbatimin e ligjit janë përgjegjëse për identifikimin e veprave penale dhe mbledhjen e provave që mbështesin ndjekjen e këtyre veprave në gjykatë me qëllim të sjelljes së kryerësve para drejtësisë. Viktimat, si subjekt i krimit, janë burime të rëndësishme të informacionit për zbatuesit e ligjit. Zyrtarët policor janë zakonisht organi i parë shtetëror që vendos kontakt me viktimën e krimit. Si të tillë, është me rëndësi që zyrtarët policor t'i kuptojnë dhe respektojnë të drejtat e viktimave të krimit. Pasi që mbrojtësit e viktimave kanë mandat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave të krimit, është me rëndësi që këto dy grupe të punojnë së bashku për arritjen e qëllimeve të tyre.
- II. Mbrojtësit e viktimave duhet të mbajnë komunikim të vazhdueshëm me policinë për të mundësuar shkëmbim më të mirë të informatave.
- III. Mbrojtësit e viktimave duhet t'i këshillojnë dhe të sensibilizojnë zyrtarët policor lidhur me të drejtat e viktimës dhe obligimin e tyre për t'i respektuar të drejtat e tyre.
- IV. Mbrojtësit e viktimave mund t'i rekomandojnë zyrtarëve të zbatimit të ligjit që ta shtyjnë intervistën me viktimën kur mbrojtësi i viktimave e përcakton që shtyrja e intervistës është në interesin më të mirë për gjendjen emocionale apo fizike të viktimës. Në rrethana të tilla, mbrojtësi i viktimave do ta bashkërendojë intervistën dhe të përkujdeset që ajo të mbahet sa më shpejtë në kohën më të përshtatshme për mirëqenien e viktimës.
- V. Sipas nevojës, mbrojtësi i viktimave do të koordinojë me zyrtarët policor transportimin e sigurt të viktimës gjatë procedurës prapake.
- VI. Kur mbrojtësi i viktimave vihet në dijeni për ndonjë rrezik të mundshëm për viktimën, mbrojtësi i viktimave e raporton atë rrezik te zyrtarët policor.

Pika 24 - Bashkërendimi i mbrojtësit të viktimave me prokurorin

- I. Mbrojtësit e viktimave dhe ZMNV-ja kanë përgjegjësi për lehtësimin e komunikimit ndërmjet tyre dhe prokurorisë. Komunikimi efektiv ndërmjet këtyre akterëve shtetëror e lejon bashkërendimin e burimeve për mbrojtje më të mirë të të drejtave të viktimave në sistemin e drejtësisë duke e zvogëluar kështu barrën e të dy zyrave. Nevoja për bashkëpunim të ngushtë mes prokurorit dhe mbrojtësve të viktimave është paraparë edhe me Rregulloren për Prokurorin e Shtetit dhe Rregulloren nr.02/2024 për mandatin, strukturën, funksionimin dhe organizimin e Zyres për mbrojtje dhe ndihmë viktimave.
- II. Komunikimi efektiv mundëson që ZMNV t'i mbrojë viktimat nga riviktimizimi gjatë ofrimit të shërbimeve nga institucionet.
- III. Bashkërendimi mbrojtës i viktimave -prokuror nënkupton:
 - a. Qasjen dhe sigurimin e shkresave të lëndës;
 - b. Dërgimi i ftesave dhe njoftimeve brenda afatve ligjore sipas KPRRK gjatë intervistimit dhe marrjes së deklaratave;
 - c. Njoftimi nga ana e mbrojtësit të viktimave për ekzistimin e urdhrit mbrojtës në fuqi;
 - d. Njoftim i prokurorit për plotësimin e deklaratës së dëmit;
 - e. Ofrimin e ndonjë prove eventuale ose propozim për marrjen e ndonjë prove;
 - f. Sipas nevojës njoftimin e prokurori për veprimet e ndërmarra në mbrojtje të viktimës;
 - g. Sigurimin që interesat e viktimës të merren në konsideratë gjatë procedurave gjyqësore apo procedurat alternative. Më specifikisht, mbrojtësi i viktimave të kërkojë plotësimin e kushteve në rastet e marrëveshjes për pranimin e fajësisë sa i përket kompensimit të viktimës.
 - h. Mbrojtësi i viktimave të kërkojë nga prokurori që paraprakisht të koordinohen në rastet kur caktohet seanca për matjen e dënimit;
- IV. Udhëheqësi i zyrës regjionale sigurohet që veprimet e sipërpërmendura të zbatohen nga ana e Mbrojtësve dhe prokurorëve. Në rast të pengesave në zbatim, mbrojtësit e viktimave njoftojnë udhëheqësin e zyrës i cili ka për obligim të koordinohet me Kryeprokurorin e prokurorisë përkatëse. Për të lehtësuar bashkërendimin e mbrojtësve të viktimave me prokuror, në koordinim me Kryeprokurorin, udhëheqësi merr pjesë në kolegjiunet e prokurorisë përkatëse.
- V. Udhëheqësi poashtu mund të kërkojë formalisht nga prokurori që të përfshijë emrin e mbrojtësit të viktimavë si përfaqësues i palës së dëmtuar/viktimës në dokumentet që i dorëzohen gjykatës.

Pika 25- Bashkërendimi i mbrojtësve të viktimave me gjykatën

- I. Mbrojtësi i viktimave si përfaqësues i autorizuar e përfaqëson viktimën si palë të dëmtuar në gjykatë sipas KPRRK me qëllim të mbrojtjes së interesave të viktimës. Përfaqësimi nënkupton në seancat gjyqësore sipas ftesës së gjykatës dhe në të gjitha rastet kur viktimë e jep pëlqimin për t'u përfaqësuar.

- II. Mbrojtësi i viktimave është i obliguar që të merr pjesë në seancat gjyqësore për përfaqësimin e viktimës në procedurat penale dhe procedurat për urdhër mbrojtës të rregullt dhe emergjent, siç është e paraparë në Ligjin për mbrojtjen ndaj dhunës në familje, dhunën në bazë gjinore dhe dhunën ndaj gruas. Kjo përfshin paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për ta mbështetur kërkesën. Përfaqësimi i mbrojtësit të viktimave në gjykatë përfshinë veprimet e nevojshme për të kërkuar, siguruar, ndryshuar, zgjatur urdhrin për mbrojtje dhe kur është e nevojshme edhe për t'u ankuar kundër aktvendimit të gjykatës për urdhrin për mbrojtje. Mbrojtësi i viktimave është i obliguar të dorëzojë kërkesën për urdhër mbrojtje në gjykatë në afatin sa më të shkurtër kohor pas pranimit të rastit dhe përplimit të kërkesës me viktimën. Mbrojtësi i viktimave është i obliguar të respektojë afatet ligjore për parashtrimin e kërkesave për urdhër mbrojtje dhe të mos vonojë dorëzimin e tyre në gjykatë. Mbrojtësi i viktimave gjithashtu e ndihmon viktimën në përpilimin e parashtrësave dhe mjeteve tjera lidhur me urdhrin për mbrojtje. Me rastin e parashtrimit të ankesës, mbrojtësi i viktimave thirret në nenin përkatës Neni 16, nënparagrafi 5 të Ligjit të lartpërmendur, i cili ia jep autorizimin mbrojtësit për të parashtruar ankesën në emër të viktimës.
- III. Mbrojtësi i viktimave si pjesë e prokurorisë së shtetit nuk merr pjesë në përfaqësimin e viktimave në procedurat tjera të rregullta juridiko-civile, po për këto mbrojtësi i viktimave e referon viktimën në agjencitë tjera të cilat i ofrojnë këto shërbime.
- IV. Mbrojtësi i viktimave, kur vepron si përfaqësues i autorizuar, është i obliguar ta njoftojë gjykatën me kohë për mungesën e tij/saj në seancën gjyqësore, përndryshe vlejné dispozitat ndëshkimore në pajtim me nenin 304 të KPPRK.
- V. Mbrojtësi i viktimave gjatë përfaqësimit në gjykatë merr rol aktiv në mbrojtjen e intersave të viktimës, përfshirë por pa u kufizuar në parashtrimin e pyetjeve për dëshmitarin, paraqitjen e fjalës hyrëse, fjalës përfundimtare, propozim për dëshmitarë, propozim për prova shtesë, propozim për ekspertë etj.
- VI. Viktimat shpeshherë nuk kanë njohuri për sistemin dhe procedurat gjyqësore. Mbrojtësi i viktimave e njofton viktimën lidhur me procedurat gjyqësore, ia komunikon viktimës kërkesat e gjykatës, procesin se si zhvillohet seanca gjyqësore dhe e përgatitë viktimën për marrjen në pyetje në vecanti nga ana e avokatit mbrojtës të pandehurit.
- VII. Çdo ndihmë juridike që mbrojtësi i viktimave e siguron për viktimën duhet të jetë në lidhje me:
 - a. aktin apo veprën penale që është nën hetim apo që është duke u ndjekur në sistemin e drejtësisë penale apo
 - b. objektin e kërkesës për urdhër mbrojtës.

Pika 26- Bashëkrendimi me mekanizmat koordinues të nivelit qendror dhe lokal

- I. ZMNV është i obliguar të merr pjesë dhe të kontribuojë në mekanizmat e nivelit qendror për mbrojtjen e viktimat përfshirë grupin koordinues ndër-ministror për

mbrojtjen nga dhuna në familje dhe Autoritetin kombëtar kundër trafikimit me njerëz.

- II. ZMNV është i obliguar të merr pjesë dhe të kontribojë në mekanizmat koordinues lokal kundër dhunës në familje, dhunë në bazë gjinore dhe dhunën ndaj gruas.
- III. ZMNV është i obliguar të ofrojë informata dhe të dhëna statistikore lidhur me rastet e trajtuara sipas mandatit të ZMNV.
- IV. ZMNV është i obliguar të regjistrojë të dhënat në databazat nacionale për rastet e dhunës në familje dhe trafikimit me njerëz.

Pika 27- Bashkërendimi me ofruesit tjerë të shërbimeve

- I. ZMNV-ja e referon viktimën te ofruesit tjerë të shërbimeve të cilët ofrojnë shërbime të mëtutjeshme për viktimat. Mbrojtësit e viktimave janë të obliguar që të ndërhyjnë në emër të viktimës për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut të viktimave nga ofruesit tjerë të shërbimeve. ZMNV-ja mund t'i bashkërendojë këto shërbime për të siguruar trajtimin me ndjeshmëri, respekt dhe dinjitet të viktimës.
- II. Bashkëveprimi me strehimoret. - Mbrojtësi i viktimave ndërvepron dhe bashkëpunon edhe me strehimoret për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, dhe trafikimit me njerëz në rajonin e tyre përkatës. Strehimoret ofrojnë strehim afatshkurtër si dhe shërbime tjera mbështetëse për viktimat dhe fëmijët e tyre pas viktimizimit me qëllim të riintegrit të tyre në shoqëri. Mbrojtësi i viktimave sigurohet që strehimorja dhe përmes strehimores edhe viktimat të informohet paraprakisht për seancat e caktuara dhe të sigurohet prezenca e viktimës kur të kërkohet paraqitja e viktimës në gjykatë. Mbrojtësi i viktimave mund ta kontaktojë dhe ta takojë viktimën edhe në hapësirat e strehimores.
- III. Bashkëveprimi me Agjencinë për ndihmë juridike falas .- Agjencia për ndihmë juridike falas ofron mbështetje, ndihmë juridike dhe avokim falas për viktimat veçanërisht në procedura civile si shkurorëzimet, kontestet për kujdestarinë, paditë civile, etj. Mbrojtësit i viktimave i referojnë viktimat në zyret për ndihmë juridike falas në rajonet e tyre për t'u siguruar që shërbimet e tilla të ofrohen për viktimat e krimeve të dhunshme. Mbrojtësit e viktimave i referojnë viktimat në zyret për ndihmë juridike falas përmes një dëshmie të rastit se pala e referuar është viktimë.
- IV. Bashkëveprimi me Qendrën për punë sociale (QPS). - Mbrojtësit e viktimave u ofrojnë ndihmë viktimave në sigurimin e të drejtave, mjeteve dhe shërbimeve nga agjencitë tjera, përfshirë bashkërendimin me shërbimet e strehimit, ndihmën sociale dhe qasjen në edukim për fëmijë. QPS-ja gjithmonë thirret për reagim në rastet kur ka fëmijë (apo të rritur që kanë nevojë për kujdestari) të përfshirë në rast qoftë si viktimat të drejtpërdrejta ose të tërthorta. Në rastet e tilla QPS-ja e siguron të gjithë ndihmën e nevojshme.
- V. Bashkërendimi me Organizatat joqeveritare të cilat ofrojnë ndihmë juridike pa pagesë për kategori të ndryshme të viktimave të krimit. Mbrojtësit e viktimave duhet të jenë në dijeni për OJQ-të në rajonet e tyre përkatëse dhe t'i këshillojnë viktimat edhe për shërbimet që këto OJQ i ofrojnë për to.

KREU V

PËRGJEGJËSITË E MBROJTËSVE TË VIKTIMAVE PËR TË NDIHMUAR VIKTIMËN NË PARAQITJEN E KËRKESËS PËR DËMSHPËRBLIM DHE KOMPENSIM

Pika 28-Dëmshpërblimi në procedurë penale

- I. Viktimat gjatë tërë procedurës kanë të drejtë të kërkojnë kompensim të arsyeshëm të urdhëruar nga gjykata nga kryesi i veprës penale. Mbrojtësi i viktimave është i obliguar ta njoftojë viktimën dhe ta ndihmojë atë që më së largu deri në 60 ditë nga ngritja e aktakuzës, mund të paraqes 'Deklaratën mbi dëmin' e shkaktuar. Mbrojtësit e viktimave mund ta ndihmojnë viktimën në plotësimin dhe dorëzimin e një deklarate të tillë, e cila mund të shërbejë edhe si kërkesë pasurore në procedurën penale.
- II. Mbrojtësi viktimave gjatë procedurës penale i rikujton viktimës të drejtën për kërkesën pasurore juridike ndaj kryesit dhe e informon se dështimi apo refuzimi për të parashtruar një kërkesë të tillë ndaj kryesit në procedurën penale paraqet një nga bazat për refuzimin e kërkesës për kompensim nga shteti sipas Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr. 08/L-109. Viktima nuk ka të drejtë të zgjedhë të mos kërkojë dëmshpërblim nga kryesi e ta kërkojë atë vetëm nga shteti.

Pika 29- Dëmshpërblimi në procedurë civile

Nëse viktimës nuk i jepet kompensim në procedurën penale, mbrojtësi i viktimave e këshillon viktimën që ai/ajo mund të kërkojë kompensim në procedurë civile përmes ndihmës juridike, avokatit privat apo vetëpërfaqësimit. Mbrojtësi i viktimave poashtu e njofton viktimën për mundësinë e kompensimit nga shteti dhe kufizimet që parashah ligji sa i përket kompensimit të dyfishtë (në këto raste konsultohet Ligji për kompensimin e viktimave të krimit). Mbrojtësi i viktimave nuk mund të përfaqësojë viktimën në procedurën e rregullt juridiko-civile për paraqitjen e kërkesës pasurore-juridike.

Pika 30- Kompensimi nga shteti

- I. Programi për kompensimin e viktimave është program i hartuar për t'i ndihmuar viktimat në kompensimin financiar për dëmet që rezultojnë drejtpërdrejtë nga vepra penale të cilat nuk ka qenë e mundur të realizohen nga kryesi apo burimet tjera. E drejta për kompensim nga shteti është e përcaktuar me Ligjin për kompensimin e viktimave të krimit. Ky ligj përcakton edhe kushtet që një viktimë të merret në konsideratë për kompensim nga shteti.

- II. Mbrojtësi i viktimave është përgjegjës që gjatë tërë procedurës ta njoftojë viktimën për programin e kompensimit të viktimave dhe kur t'i kërkohet nga viktimata edhe t'i ndihmojë edhe në plotësimin dhe paraqitjen e kërkesës për kompensim. Mbrojtësi i viktimave në asnjë rrethanë nuk i jep premtim viktimës që ai/ajo do ta marr kompensimin.
- III. Mbrojtësi i viktimave informon viktimat e kategorive të caktuara sipas ligjit të cilat kanë të drejtën për kompensim të menjëhershëm nga shteti dhe e udhëzon viktimën të ruaj provat dhe dokumentet relevante për të dëshmuar dëmin e shkaktuar, si për kompensim të menjëhershëm edhe për kompensimin e rregullt.

KREU VI

FORMULARËT E PRAKTIKËS NË ZMNV

- I. Mbrojtësit e viktimave kanë për obligim t'i përdorin formularët standard të hartuar në kuadër të PSV-ve për kërkesat, ankesat në shkallë të dytë, deklaratat apo format për parashtrësat e ndryshme për gjykatën , për realizimin e kërkesave të ndryshme për viktimat e krimit, si dhe format standarde të kërkesave brenda ZMNV-së .
- II. Formularët e praktikës në ZMNV janë të bashkangjitur si shtojcë në këtë udhëzim.

KREU VII

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Pika 31-Detyrimet që rrjedhin nga aktet tjera

- I. Mbrojtësit e viktimave si zyrtarë publik i nënshtrohen kufizimeve të parapara me dispozitat e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit.
- II. Të gjithë zyrtarët e ZMNV pa përjashtim kanë për obligim respektimin e dispozitave përkatëse lidhur me trajtimin e viktimave, shërbimeve që atyre duhet t'u ofrohen, parandalimin e konfliktit të interesit, dhe të gjitha detyrimeve tjera të parapara me Rregulloren për ZMNV, Kodin e etikës dhe këto PSV. Shkelja e këtyre detyrimeve paraqet bazë për inicimin e procedurave disiplinore në pajtim me Rregulloren Nr.05/2024 për procedurë disiplinore të stafit administrative në sistemin prokurorial të Kosovës.


Pika 32- Zbatimi

- I. Obligohet Zyra për mbrojtje dhe ndihmë viktimave dhe prokurorët e shtetit në zbatimin e këtij Udhëzimi.
- II. Obligohet Koordinator i ZMNV të përcjellë zbatueshmërinë e këtyre PSV-ve.

Pika 33 - Hyrja në fuqi

- I. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi shfuqizohet Udhëzimi mbi procedurat standard të veprimit me nr. 181/2013 , të datës 18.10.2013
- II. Ky Udhëzim hyn në fuqi me datë 05.11.2024


Besim Kelmendi
U.D. Kryeprokuror i Shtetit



Shtojca.FORMULARËT E PRAKTIKËS NË ZMNV

1. Kërkesa për urdhër mbrojtje të rregullt
2. Kërkesa për ndryshim, ndërprerje dhe vazhdim të urdhrit për mbrojtje
3. Kundërshtimi
4. Ankesa për gjykata
5. Deklarata e pëlqimit të viktimës për ndihmë
6. Deklarata mbi dëmin _fq1
7. Deklarata mbi dëmin _fq2
8. Deklarata për pranimin e kompensimit
9. Shënim zyrtar
10. Forma për parashtresa dhe kërkesa
11. Forma e kërkesës për ekspertim psikosocial
12. Forma e Raportimit-Linja ndihmëse
13. Regjistri i thirrjeve- Linja ndihmëse
14. Shënimi zyrtar-Linja ndihmëse
15. Forma për këshilla për planifikimin e sigurisë për viktimën-Linja ndihmëse
16. Formulari për planifikimin e kujdestarisë
17. Formulari për kujdestarinë e mbajtur
18. Forma për Furnizim me material për zyre
19. Kërkesa për tërheqjen e automjetit